

**FEDERATA E BOKSIT  
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION  
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: [fboxk@hotmail.com](mailto:fboxk@hotmail.com)  
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova  
NLB Bank No: 1701001010850503

Në bazë të nenit 26 nenpika 4 e statutit të FBOXK në mbledhjen e  
anëtarve të kuvndit të mbajtur me 05.05.2022 miratoj :

**RREGULLORE MBI PUNËN E  
KËSHILLIT MBIKQYRËS  
TË FEDERATËS SË BOKSIT TË KOSOVËS**

**05.05.2022**

**FEDERATA E BOKSIT  
E KOSOVËS**



**BOXING FEDERATION  
OF KOSOVA**

Tel/Fax: +383 38 247 578; Mob: +383 44 112824,44 208 215 E-mail: [fboxk@hotmail.com](mailto:fboxk@hotmail.com)  
Adress: Str. Agim Ramadani no: 43, House of Sport I floor no3, 10000 Pristina, Kosova  
NLB Bank No: 1701001010850503

## Dispozitat e Pergjithshme

### **Neni 1.**

Me këtë Rregullore, rregullohet mënyra e punës të drejtat dhe obligimet, e anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të FboxK-së.

### **Neni 2**

Këshillin mbikëqyrës e përbëjnë tre anëtarë, njëri prej tyre është kryetar.

### **Neni 3**

Anëtarët e Këshillit mbikëqyrës i zgjedh Kuvendi nga radhët e delegatëve të Kuvendit apo edhe punëtor sportiv, të cilët janë punëtorë të dalluar sportiv dhe gëzojnë autoritet në Federatën e Boksit të Kosovës.

Anëtari i këshillit mbikëqyrës nuk mundë të jetë anëtarë i organeve dhe trupave të Federatës.

### **Neni 4**

Kryetari i Këshillit mbikëqyrës zgjedhët në Kuvendin e FboxK-së, i cili e udhëheq Këshillin mbikëqyrës.

Këshilli mbikëqyrës vendimet e veta i merr me shumicë votash.

### **Neni 5**

Mandati i anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës është 4 vjet dhe nuk është i kufizuar.

Mandati i Këshillit mbikëqyrës fillon menjëherë pas mbledhjes së Kuvendit zgjedhor.

## Neni 6

Mbledhjet e Këshillit mbikëqyrës i konvokon kryetari në:

- Bazë të vlerësimit vetjak,
- Kërkesës së kryetarit të Bordit të FboxK-së,
- Kërkesës së më tepër se gjysmës së anëtarëve të Bordit ekzekutiv dhe
- Kërkesës së 2/3 të anëtarëve, delegatëve të Kuvendit.

## Neni 7

Këshilli mbikëqyrës mbikëqyr punën e organeve të Kuvendit të Federates së Boksit të Kosovës të përcaktuara me Statut në mes të dy Kuvendeve.

Mbi gjendjen e konstatuar dhe mendimin lidhur me masat e njofton kryetarin, organet e Bordit dhe Kuvendin e FboxK-së dhe propozon masat për përmirësimin e gjendjes në suaza të dispozitave të Statutit dhe akteve të tjera të FboxK-së, në veçanti ndjek realizimin e planit financiar, duke propozuar masa gjegjëse, të cilat janë obligative.

## Neni 8

Anëtarët e Këshillit Mbikëqyrës në seancë nuk mund të apstenojnë nga votimi.

## Neni 9

Në seancën e Këshillit Mbikëqyrës mbahet procesverbali  
Procesverbalin e mban Sekretari i përgjithshëm i FboxK-së.

## Neni 10

Për mos respektimin e dispozitave të kësaj Rregulloreje nga ana e anëtarëve të Këshillit mbikëqyrës, do të mirren masa adekuate disiplinore.

## Neni 11

Kjo Rregullore hynë në fuqi ditën e miratimit.

Kryetari i FboxK-së  
Enver Krasniqi



Prishtinë më  
05.05.2022

